



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA DURRES
DREJTORIA E SHERBIMEVE PUBLIKE
Sheshi "Liria" , tel +355 52 234 54 tel/fax +355 52 223 10
e- mail: info@durres.gov.al

RELACION TEKNIK

OBJEKTI : PUNIME EMERGJENCE PER RRESHQITJEN E DHEUT KODER VILE (tek kthesa e viles Redizenciale)

Studimi gjeologjik i bërë për rikonstruksionin e rrugës Vilës kishte për qëllim saktësimin e shkëmbinjve rrënjësor në sektorin e dëmtuar të trasesë së rrugës në anën jug perëndimore të vilës. Për këtë qëllim krahas vërtetimeve fushore u shpuan dhe 4 (katër) puse nga |2m| të thellë me koronë Φ 110 mm.

Në këtë sektor kodrinor në jug perëndim janë të pranishëm pothuajse të gjithë faktorët që favorizojnë fenomene rrëshqitjeje të herë pas herëshme të masivëve të tokës. Ndërtimi gjeologjik i tokës përfaqëson formime të reja të Kuaternarit. Shkëmbinjtë neogjenik të Pliocenit përfaqësohen nga shtresa jopotente të argjilave, aleuroliteve dhe ranorëve që ndërthuren midis tyre në formë shtresash të holla disa cm. Morfologjia e relievit dhe vetë ndërtimi i brendshëm strukturor nën ndikimin e faktorëve dhe agjentëve atmosferik favorizojnë ndjeshëm zhvillimin e proceseve të tjetërsimit, shpëlarjen, transportin dhe depozitimin e tyre në zonat e ulura (deluvionet) duke manifestuar sapo paraqiten kushtet , fenomenin e rrëshqitjes.

Ndikim në qëndrueshmërinë e shpateve kanë ujrat sipërfaqësore dhe ato të filtrimit mungesa e pamjaftueshme e pyllëzimit, mungesa e tarracimeve gjë që bën shkarjen masive deluviale.

Duke marrë në konsideratë këto faktorë gjeologjik u morën të gjitha masat për stabilizimin e trasesë së rrugës në anën jug perëndimore . Inkastrimi i strukturës mbajtëse u realizua me pilota duke kapur shtresën rrënjësore të Pliocenit të sipërm të përfaqësuar nga argjila të kaltra me teksturë masive. Strukturat ekzistuese të mureve mbajtës u përforcuan me mure kundra forcë, strukturat e reja u regjistruan me ato ekzistuese.

Si konkluzion kjo shkarje nuk cënon strukturën mbajtëse të trasesë së rrugës por dhe nga studimi gjeologjik i kryer lind nevoja për përforcimin e sistemit kodrinor poshtë trasesë me ndërhyrje inxhinierike, por që nuk mund të kryheshin me investimin e rrugës e cila kishte qëllim tjetër.

Ajo që e bën emergjente ndërhyrjen në këtë zonë është se në ish skarpatën poshtë rrugës, kalon kolektori i KUB që ndjek izoipsin dhe përcjell ujrat e bardha nga ana veri -

perëndimore e vilës në anën jugore të saj për të udhëzuar në kolektorin e KUB së rrugës. Ky kolektor , në zonën që ka rrëshqitur, është dëmtuar dhe ka ikur bashkë me masivin e dheut , dhe po nuk u morën masa të menjëhershme, ujrat e tij favorizojnë akoma më shumë rrëshqitjen dhe janë rrezik evident për banesat në drejtim të shkollës Italjane.

Zgjidhja inxhinierike e propozuar , përforcon zonën e rrëshqitur dhe krijon kushte për ribërjen e kolektorit KUB në kushte të qëndrueshme.

Vlera e preventivuar për realizimin e këtij projekti me vlerë 4'937'017 leke do të merret nga fondi për emergjencat civile.

Zgjidhja konsiston në ndërtimin e një muri mbajtes me lartësi $L=4.5\text{m}$ në largësi 10-12 m nga skaji i trotuarit konsol të rrugës së vilës. Ky mur do të ketë pilota me thellësi $H=8\text{m}$ të cilët do të jenë të armuar një po një jo dhe fitilat e pilotës do të lihen 1 m jashtë për të xhuntuar me mirë me ato të murit mbajtes.

Fillimisht do të bëhet gërmimi i skarpates dhe taracimi për vendqendrimin e sondës në mënyrë që pozicionimi i saj të jetë sa më i qëndrueshëm.

Pilotat hapen 8m thellësi nga Kuota Referuese. Kjo kuotë do të konsultohet paraprakisht me projektuesit.

Betoni për realizimin e Pilotave do të jetë $R8=250\text{kg/cm}^2$.

Pilotat të vendosen afër njëra-tjetrës.

Hekuri përforcues i pilotave të jetë me $Rak = 3200\text{ daN/cm}$.

Shtresa mbrojtëse e hekurit min = 5 cm

Radha e punës do të fillojë me pilotat e ekstremeve duke shkuar drejt qendrës së urës, pasi vendi i qendrimit nuk e lejon ndryshe.

Pas ndërtimit të murit mbajtes bëhet mbushja e vendit me dhe dhe ngjeshja e tij.

Në murin mbajtes do të vendosen tuba PVC 100 për drenazhimin e ujrave të skarpates së dherave.

FOTO TE GJENDJES AKTUAL



Albania



GRUPI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Ark, Adnand Tocila

Ing. Bashkim Salillari

Ing. Tonajdo Hudhra